



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1018/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit DPZ “Lirimi” me seli në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat A.K. kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.P., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1428/19, të datës 20.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.09.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.1428/19, të datës 20.05.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1428/19, të datës 20.05.2021 është Aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit DPZ “Lirimi” me seli në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit. Anulohet Pjesërisht aktvendimi nr.01.3.2.2/3367 i datës 13.05.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë në pjesën e vendimit ku është konfirmuar aktvendimi me nr. 03.1.1-2018-576/1 i datës 07.02.2019 i lëshuar nga ana e Sektorit të Kontrollës Pas Importuese të paditurës, me te cilin

vendim paditësi është ngarkuar me pagesën e taksës së akcizës në shumë prej 75,200.00€, dhe me Tatim Mbi Vlerën e Shtuar të llogaritur mbi bazën e kësaj shume në vlerë prej 13,536.00€, në emër të 41 automjeteve të pa zhdoganuara të gjetura tek paditësi me datë 26.11.2018, automjete këto të vlerësuara nga e paditura në vlerë të përgjithshme prej 105,659.00€. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit DPZ “Lirimi” me seli në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, ta liroj nga pagesa e detyrimeve importuese doganore, përkatësisht Taksa e Akcizës në shumë prej 75,200.00€ dhe TVSH-ja e llogaritur mbi bazën e kësaj shume në vlerë prej 13,536.00€. Mbetet në fuqi aktvendimi nr.01.3.2.2/3367 i datës 13.05.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë në pjesën ku është konfirmuar aktvendimi me nr.03.1.1-2018-576/1 i datës 07.02.2019 i lëshuar nga ana e Sektorit të Kontorllës Pas Importuese të paditurës me të cilin vendim paditësi është obliguar që në emër të 41 automjeteve të pa zhdoganuara të gjetura tek paditësi me datë 26.11.2018, automjete këto të vlerësuara nga e paditura në vlerë të përgjithshme prej 105,659.00€ të paguaj taksën doganore prej 10% në shumë prej 10,565.90€ dhe TVSH-ja e llogaritur mbi bazën e kësaj shume në vlerë prej 20,920.48€ apo gjithsej detyrime importuese doganore në vlerë prej 31,486.38€. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar e paditura për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës LKA. Me propozim që të aprovohet e bazuar ankesa në tërësi si të bazuar me ligj, të prish Aktgjykimin A.nr.1428/19 të datës 20.05.2021 si të pa bazuar në ligj, dhe të lënë në fuqi aktvendimin e kontestuar ose t’ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së dytë. shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/3367 i datës 13.05.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë DPZ “Lirimi” fshati Krushë e Madhe, për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.1-2018-576 të datës 07.02.2019 i lëshuar nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/3367 i datës 13.05.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, e pas administrimit të provave si në procesverbale të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar pjesërisht aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se gjykata ka vlerësuar se e paditura pa bazë ligjore e ka ngarkuar paditësin me obligimin doganor të pagesës së taksës së akcizës në shumë prej 75,200.00€ dhe me Tatim Mbi Vlerën e Shtuar të llogaritur mbi bazën e kësaj shume në vlerë prej 13,536.00€ në emër të 42 automjeteve të pa zhdoganuara të gjetura tek paditësi me datë 26.11.2018, automjete këto të vlerësuara nga e paditura në vlerë të përgjithshme prej 105,659.00€ për arsye se në rastin konkret sipas vlerësimit të gjykatës e paditura nuk ka arritur të provoj me prova dhe dëshmi konkrete pretendimin se malli-automjetet e gjetura tek paditësi me datë 26.11.2018 me rastin e kontrollit të zhvilluar është malli i cili i nënshtrohet taksës së akcizës siç përcaktohet me dispozitat e nenit 293 parag.5, 6 dhe 12 të KDAK-së. Tutje gjykata konstaton se kur e paditura e ka ngarkuar paditësin me detyrime importuese doganore, respektivisht taksë të akcizës në vlerë prej 75,200.00€ dhe TVSH-në e llogaritur mbi bazën e kësaj shume për vlerën e mallit të vlerësuar prej 105,659.00€ nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejt dispozitat ligjore të KDAK-së dhe të Ligjit nr.05/L-132 për Automjete, sepse në rastin konkret vet e paditura në vendimin e kontestuar e ka pranuar faktin se në listën e automjeteve që nuk i kanë paguar taksat doganore, shumica prej automjeteve janë më të vjetra se 10 vjet dhe se kjo vërtetohet edhe nga aktvendimi me nr. 03.1.1-2018-576/1 i datës 07.02.2019 me të cilin paditësi është obliguar ti paguaj detyrimet importuese doganore të lartë cekura. Gjykata vlerëson se e paditura nuk mund të ngarkoj paditësin me pagesën e taksës së akcizës për një mall i cili ligjërisht nuk mund të importohet në Kosovë për qëllime të regjistrimit dhe lëvizjes së lirë kjo sipas nenit 44 par2 të Ligjit nr.05/L-132 për

Automjete dhe i cili nuk mund të nënshtrohet vendosjes së qarkullim të lirë sepse një gjë e tillë përcaktohet edhe në dispozitën e nenit 234 të KDAK-së ku shprehimisht thuhet se *"Akciza është taksë e cila u ngarkohet produkteve me akcizë të lëshuar në qarkullim në Kosovë"*. Në këtë linjë është edhe dispozita e nenit 237 para.1 të KDAK-së ku parashihet që *"Secilit produkt me akcizë i caktohet akciza në tarifën e cila vlen për të në datën dhe kohën kur produkti lëshohet në qarkullim në Kosovë"*. Andaj Gjykata konstaton se përderisa malli-automjetet e gjetura tek paditësi nuk kanë mundur të regjistrohen në Kosovë sipas Ligjit nr.05/L-132 për Automjete për shkak se kanë qenë më të vjetra se 10 vite, rrjedhimisht nuk kanë mundur as ti nënshtrohen procedurës së homologimit, për të marr certifikatën e homologimit dhe procedurës së kontrollit teknik, për të marr certifikatën mbi klasifikimin e rregullsisë teknike të automjetit të paraparë me ligjin e përmendur dhe nenin 5 të UA nr.01/2018 për regjistrimin e mjeteve. Në nenin 13 të UA nr.2/2018 për Përcaktimin e Kushteve dhe Procedurave për Homologim të Mjeteve Rrugore par 4 pika 4.4 është përcaktuar se *"Certifikata e homologimit individual për mjetin rrugor është dokument i cili i mundëson mjetit rrugor importimin, regjistrimin, për përdorim në trafikun rrugor"*.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejt ka konstatuar se padia e paditësit është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së,

Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk i ka administruar provat për të vërtetuar gjendjen faktike, por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerrë konkluzion të gabuar duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke bërë vlerësim të gabuar dhe interpretim të gabuar duke liruar paditësin nga pagesa e akcizës për automjete, e duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për komunikacion rrugor. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, sepse vet e paditura Dogana e Kosovës në një rast të ngjashëm sikurse në rastin konkret me paditësin, përmes aktvendimit me nr.04.3.2/456 të datës 07.10.2011 për 16 automjete të gjetura tek ai subjekt të cilat kanë qenë të pa zhdoganuara por në vlerë prej 7,300.00€ e ka obliguar të njëjtin me pagesën e taksës doganore prej 10% në vlerë prej 730.00€ dhe TVSH në vlerë prej 1,284.80€ pro jo edhe me pagesën e akcizës, ndërsa në këtë rast paditësin e ka ngarkuar edhe me pagesën e taksës së akcizës në shumë prej 75,200.00€ dhe TVSH-në shtesë të llogaritur mbi bazën e kësaj shume prej 13,536.00€. Duke vepruar në këtë mënyrë gjykata vlerëson se e paditura nuk ka zbatuar në mënyrë unike dhe të njëtrajtshme legjislacionin doganor në tërë territorin e Republikës së Kosovës siç parashihet me dispozitat e nenit 3 të KDAK-së. Tutje gjykata ka vlerësuar se nga shkresat e lëndës e paditura me të drejtë paditësin e ka ngarkuar me pagesën e taksës së doganës prej 10% në shume prej 10,565.90€ dhe me TVSH-në shumë prej 20,920.48€ e cila TVSH ndryshoj nga vlera prej 34,456.48€ e llogaritur nga e paditura në aktvendimin me nr.03.1.1-2018-576/1 e datës 07.02.2019 sipas precizimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor pas parashtrimit të kërkesës për lirim nga detyrimi i pagesës së taksës së akcizës në vlerë prej 75,200.00€ për mallin-automjetet e pa zhdoganuar të gjetura tek paditësi me rastin e realizimit të kontrollit nga e paditura me datë 26.11.2018 në vështrim të dispozitës nga neni 200, par.1, 2 dhe 3 pika c) të KDAK-së ku shprehimisht parashihet se ku është parashikuar se: *1. Borxhi doganor në import lind me rastin e shmangies së paligjshme nga mbikëqyrja doganore e mallrave, të cilat i nënshtrohen obligimit të pagesës së detyrimeve të importit. 2. Borxhi doganor lind në çastin kur mallrat i shmangen mbikëqyrjes doganore. 3. Debitor do të jetë: c) çdo person që blen ose i*

mban mallrat në fjalë dhe në çastin e blerjes ose të mbajtjes së mallrave ishte në dijëni ose objektivisht duhej të ishte në dijëni, se ato mallra janë larguar nga mbikëqyrja doganore” , por nuk ka vepruar kështu edhe sa i përket taksës së akcizës dhe diferencës së TVSH-së në vlerë prej 13,536.00€ të llogaritur mbi bazën e taksës së akcizës prej 75,200.00€, për arsye se ato automjete nuk kanë mundur të dalin në qarkullim të lirë nuk ka mundur të regjistrohen dhe as të përdoren për transport të personave, për çka është e ngarkueshme edhe taksa e akcizës sipas Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar ky me Ligjin me nr.03/L-220.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjen se gjykata e shkallës së parë, nga dëshmitë e nxjerra me të drejt ka konstatuar se Dogana e Kosovës, në mënyrë të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuara është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamjet të gjendjes faktike për pasoj edhe dispozitat ligjore nuk janë aplikuar drejtë përkundër të gjitha dokumenteve, ku e paditura nuk ka mundur që klasifikimin tarifor të mallit lëndor të gjetur tek paditësi ta bazoj në mendimet për klasifikim tarifor të cilat janë nxjerr për automjete tjera të cilat nuk kanë të bëjnë fare me subjektin në procedurë këtu paditësin dhe mallin e gjetur tek ai por kanë të bëjnë me një subjekt dhe vetura tjera dhe kjo vërtetohet edhe nga fakti se këto mendime janë nxjerr me datë 22.10.2015 ndërsa kontrolli tek paditësi është ushtruar nga ana e zyrtarëve të paditurës të SKPI me datë 26.11.2018. Prandaj, kolegji i kësaj gjykate nuk i merr si të bazuara pretendimet e të paditurës se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, dhe me këtë rast gabimisht kanë aplikuar edhe dispozitat ligjore. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt, kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet e të paditurës të përsëritura të një pas njëshme ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara, për tu aprovuar

ankesa, dhe për faktin se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të padisë së paditësit dhe anulimit pjesërisht të aktvendimit të lartcekur, e pasi që me thëniet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1018/22, me datë 05.09.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**